



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 480/5 Prot.

Tiranë, më 23.10. 2015

V E N D I M

Nr. 118, datë 23/10/2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e
Këshillit të Qarkut Kukës**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenet 14, gërma "b", 32 dhe 33, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 (më poshtë "Rregullores"), si dhe neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit, observacioneve të institucionit të inspektuar dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procesin e inspektimit të përgjithshëm, zhvilluar në institucionin e Këshillit të Qarkut Kukës,

VËREJ SE:

Në zbatim të Vendimit nr. 66, datë 02.07.2015, "Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Këshilli i Qarkut Kukës", ka filluar inspektimi i përgjithshëm në subjektin, Këshilli i Qarkut Kukës.

Objekti i inspektimit është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ndër të cilat rekrutimi në shërbimin civil, zbatimi i sistemit të karrierës, lirimi nga shërbimi civil apo transferimi i punonjësve në kushtet e ristrukturimit, përshkrimet e punës, vlerësimi i punës e aspekte të tjera që kanë lidhje me veprimtarinë e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, në përmbushje të detyrimeve ligjore për administrimin e shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të inspektimit, grupi i inspektimit ka hartuar projektraportin dhe e ka dërguar për njohje në subjektin e inspektuar, me shkresën nr. 480/3 prot., datë 23.09.2015, "Dërgohet projektraporti i inspektimit në institucionin e Këshillit të Qarkut Kukës, në lidhje me procesin e ristrukturimit", duke i lënë 5 ditë afat për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, me shkresën nr. 1016 prot., datë 08.10.2015, "Observacion mbi projektraportin e mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil".

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse, rezulton se subjekti i inspektuar është shprehur përgjithësisht dakord me konkluzionet e arritura nga grupi i punës, ndërkohë që ka kërkuar rivlerësim të qëndrimit të Komisionerit në lidhje me institutin e vlerësimit të punës dhe deklarimin e statusit të punësimit. Qëndrimi ligjor i Komisionerit në lidhje me këto aspekte është pasqyruar në rubrikat përkatëse të raportit përfundimtar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të përmbajtjes së raportit përfundimtar të inspektimit, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, si dhe nenet 32, 33, të Rregullores *"Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"*, miratuar me vendimin nr. 17 datë 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Kukës, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse të revokojë aktin administrativ nr. 23, datë 28.02.2014, që emëron punonjësen ***** në detyrën *"Përgjegjëse e Zyrës së Financës"*, në Drejtorinë Juridike dhe Financës; aktin administrativ nr. 24, datë 23.07.2014, që e kategorizon si *"nëpunës civil në periudhë prove"* dhe aktin administrativ nr. 3, datë 30.07.2015, që e konfirmon si *"nëpunës civil"*, si akte që kanë dalë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë procesin e rekrutimit në shërbimin civil.

Njësia përgjegjëse të revokoj aktin nr. 3, datë 06.01.2015, që emëron nëpunësen ***** ****, mbas procesit të ristrukturimit, në pozicion *"Shef i Sektorit të Financës"*, në Drejtorinë Juridike, Financës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Njësia e burimeve njerëzore si njësia përgjegjëse për menaxhimin e shërbimit civil në institucion, duhet të shpallë si vend të lirë pozicionin e punës *"Shef i Sektorit të Financës"*, në Drejtorinë Juridike, Financës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të kujdeset për ta plotësuar atë nëpërmjet procedaurve të rekrutimit.

3. Njësia përgjegjëse të kryejë vlerësimet e rezultateve në punë, për të gjithë nëpunësit civilë të Këshillit të Qarkut Kukës, sipas formularit të vlerësimit nr. 2, bashkëngjitur dhe miratuar me vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, *"Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë"*, të Këshillit të Ministrave.

4. Njësia përgjegjëse të plotësojë praktikën e ristrukturimit, duke administruar në dosjen e personelit dokumentin që përfaqëson mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit, sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*.
5. Njësia përgjegjëse të revokojë aktin administrativ nr. 32, datë 27.03.2015, të Kryetarit, për emërimin e nëpunëses ***** në detyrën *“Përgjegjëse në Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Tropojë”*, si akt emërimi i nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Të merren masa nga njësia e burimeve njerëzore për të shpallur vendin vakant dhe për plotësimin e tij nëpërmjet procedurave të rekrutimit.
6. Njësia e burimeve njerëzore të plotësojë dosjet e personelit të çdo nëpunësi civil sipas kërkesave të përcaktuara në kapitullin nr. 6, të raportit përfundimtar që do të jetë pjesë e këtij vendimi, si dhe dokumentet e evidentuara në anekset përkatëse bashkëngjitur raportit.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i inspektuar, Këshilli i Qarkut Kukës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
9. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Kukës dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke u dërguar nga një kopje të raportit përfundimtar të inspektimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA